



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1215/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë kundër debitorëve Viva Fresh shpk me seli në lagjen Veternik, magjistralja Prishtinë-Gjilan, dhe debitorit D.Sh.S. nga Peja, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.615/22 të datës 30.05.2023, me datën 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.615/22 i datës 30.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.615/22 të datës 30.05.2023, e ka Pranuar si të bazuar propësimin e debitorit Viva Fresh shpk, ka Anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.1304/21 datë 23.09.2021, i lëshuar nga përmbartuesi privat Valdrin Beka në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i kreditorit për shkak të shkeljes se dispozitave kontestimore dhe përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta ndryshoj.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, me datën 22.09.2021, ka paraqitur propozim për përmbaerim ndaj debitorëve Viva Fresh shpk me seli në lagjen Veternik, magjstralja Prishtinë-Gjilan, dhe debitorit D.Sh.S. nga Peja, në bazë të dokumentit përmbaerimor gjobës mandatorë nr.001556/18 datës 31.07.2019 në shumën prej 2,430.00€

Përmbaeruesi privat Valdrin Beka nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaerimor P.nr.1304/2021 dt.23.09.2021, ka lejuar përmbaerimin, me të cilën detyrohet debitorit që kreditorit në emër te titullit ekzekutiv urdhëresës për pagesë për ndëshkim me gjobë mandatore nr.001556/18 dt.31.07.2019 t'i paguaj shumën prej 2,430.00€ me kamatë vonesë prej 8% nga arritja për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaerimore.

Kundër urdhrin përmbaerimor debitorit ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin për përmbaerim për shkak se kemi të bëjmë me një të drejt të parashkruar te kreditorit për faktin se urdhri për përmbaerim është nxjerr 2 vite e 3 muaj pas shqiptimit të gjobës mandatorë për kryerje të kundërvajtjes dhe në kuptim të Ligjit për kundërvajtje, sanksioni i shqiptuar kundërvajtës nuk mund të ekzekutohet nëse nga data kur vendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë, kanë kaluar mbi 1 vit, ndërsa në rastin konkret afati i parashkrimit të ekzekutimit ka kaluar dyfish, i propozon gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbaerimor.

Në përgjigje në prapësim kreditori kundërshton prapësimin e debitorit me arsyetimin se përgjatë kohës sa kreditori ka pasur të drejt të kërkoj ekzekutimin e gjobës, në vend kanë ekzistuar masat kufizuese për shkak të pandemisë covid-19, andaj kreditori ka qenë i detyruar të punoj me shërbime esenciale, i propozon gjykatës që prapësimi të refuzohet ndërsa urdhri përmbaerimor P.nr.1304/21 datës 23/09.2021 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.615/22 dt.30.05.2023, me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka arsyetuar se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbaerimit, urdhëresë për pagese për ndëshkim me gjobë mandatore nr.001556/18 datës 31.07.2019, nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbaerimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të LPP-së. Gjykata vlerëson se ky akt urdhëresë për pagese, nuk është nxjerr në harmoni me dispozitat e nenit 45,46 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative 05/L-031, sepse i mungon forma e aktit administrativ, struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaerimore me rastin e vendosjes në këtë këtë çështje përmbaerimore, sepse kreditori propozimin për përmbaerim e ka të iniciuar ne bazë te një akti që nuk i plotëson kriteret ligjore për tu konsideruar vendim

administrativ përmbareues sikurse parasheh dispozita e nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, që përcakton:

Dokumente përmbareuese janë: 1.2. vendimi përmbareues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia);

Prandaj Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se vendimi përmbareues i dhënë në procedurë administrative, për tu konsideruar si titull ekzekutiv në procedurën përmbareimore, duhet të përmbajë elementet e detyrueshme që parashihen me nenin 47 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa në rastin konkret kreditori, propozimin për përmbareim e inicon në bazë të një formulari –urdhërpagesë për gjobë mandatore, i cili nuk përmban asnjë element të aktit administrativ, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve, rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar, ndërsa kreditori nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i aprovoi pretendimet ankimore të kreditorit se dokumenti përmbareimor paraqet titull ekzekutiv, apo i plotëson kushtet ligjore për tu trajtuar si akt administrativ i dhënë në procedurë administrative sipas nenit 23 par.2 të LPP-së, sepse kjo dispozitë ligjore nuk parasheh se formulari-gjoba mandatore, është dokument i besueshëm për tu realizuar përmbareimi. Dhomat e shkallës së parë ka vepruar drejt kur me aktvendimin e atakuar, ka pranuar prapësimin e debitorit, duke zbatuar drejt ligjin.

Përndryshe në procedurën përmbareimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbareimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbareimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1215/23 me datë 26.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha